



POLITIKA NDËSHKIMORE NË “KRIMET SPECIALE”



Autorë: Zamira Krasniqi dhe Florian Smajli

Redaktorë: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) – Departamentit të Shtetit Amerikan, apo të National Endowment for Democracy (NED).

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde



Mbështetur nga:



Rreth IKD:

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorinë e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Dhjetor, 2024

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	6
2. PSRK dhe Departamentet Speciale	8
3. Efikasiteti i Departamentit Special në shkallë të parë	9
4. Efikasiteti i Departamentit Special në shkallë të dytë	10
5. Aktgjykimet në Departamentin Special të GjTh Prishtinë (2020 – 2024)	11
6. Politika Ndëshkimore e Krimeve Speciale për periudhën 2020 – 2024.....	12
7. Aktgjykimet në DS në shkallë të dytë (2020 – 2024).....	13
8. Trajtimi i “korrupsionit special”	14
a. Efikasiteti	14
b. Cilësia e të akuzuarve	16
c. Cilësia e të dënuarve	16
d. Koha e kryerjes së veprave penale.....	18
e. Politika ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit	19
f. Dënimet plotësuese	20
g. Konfiskimi	21
h. “Korrupsioni special” në shkallë të dytë.....	21

1. Përmbledhje ekzekutive

Që nga themelimi i saj në vitin 2008 e për më shumë se një dekadë, rastet e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (tutje: PSRK) nuk kishin një nivel gjyqësor ekuivalent për trajtimin e tyre. Për trajtimin e këtyre rasteve, në vitin 2019, përmes Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat, u themelua Departamenti Special (tutje: DS) në kuadër të Gjykatës Themelore (tutje: GjTh) në Prishtinë dhe DS në kuadër të Gjykatës së Apelit (tutje: GjA). DS-të kanë kompetencë të shqyrtojë lëndët të cilat bien në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (tutje: PSRK).

Krahas rregullimit të strukturës institucionale, përmes krijimit të një departamenti të specializuar për trajtimin e aktakuzave të ngritura nga PSRK, supozohej të ngritej efikasiteti, efektiviteti dhe profesionalizmi në trajtimin e rasteve të iniciuara nga PSRK. Për të analizuar zbatimin e këtyre synimeve në praktikë, IKD ka analizuar 103 aktgjykime të DS të GjTh në Prishtinë dhe 52 vendime të DS të GjA.

Gjetjet e IKD tregojnë se vit pas viti (me përjashtim të vitit 2020), DS i GjTh në Prishtinë nuk arriti të zgjidhë aq lëndë sa ka pranuar, edhe përkundër rritjes së numrit të gjyqtarëve. Kështu, numri i lëndëve në punë u rrit vit pas viti, nga 63 lëndë në pritje në fillim të vitit 2020, në 125 lëndë në fund të vitit 2023. Situata e njëjtë nuk qëndron me DS të GjA e cila e ka zgjidhur çështjen e ngarkesës me lëndë ashtu që tanimë mund të konsiderohet se kjo gjykatë nuk ka ngarkesë të pa menaxhuar me lëndë.

Sipas 103 aktgjykimeve të analizuar për periudhën 2020 – 2024, IKD ka gjetur se politika ndëshkimore për krimet speciale ka qenë e ndryshme ku prej gjithsej 319 dënimeve të shqiptuara, 158 prej tyre kanë qenë dënime me burgim efektiv, 21 dënime me kusht dhe 140 dënime me gjobë. Shprehur në përqindje i bie se 49.5% e masës së dënimeve të shqiptuara e përbëjnë dënimet me burgim efektiv, 43.8% e dënimeve të shqiptuara janë dënime me gjobë derisa 6.5% të dënimeve janë me kusht.

Sa i përket vendimmarrjes në Gjykatën e Apelit, IKD gjenë se ka një progres sa i përket rasteve të kthyer në rigjykim. Nga totali i vendimeve, DS i GjA në vetëm 3.8% të rasteve ka kthyer rastet në rigjykim. Asnjë prej këtyre vendimeve nuk i përket rasteve të korrupsionit.

Sa i përket efikasitetit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në DS të GjTh në Prishtinë, kohëzgjatja e trajtimit të lëndëve vazhdon të jetë e gjatë. Sipas aktgjykimeve të analizuar, mesatarja e trajtimit të një rasti në DS të GjTh në Prishtinë është 709.2 ditë.

Sipas aktgjykimeve të analizura në rastet e korrupsionit, bazuar në aktakuzat e PSRK, nga 70 persona të akuzuar, 40 prej tyre janë shpallur fajtorë. Shprehur në përqindje, i bie se nga 70 personat që ka akuzuar PSRK, fajësia e të akuzuarve është vërtetuar në vetëm 57.14% të tyre. Kështu, Prokuroria ka dështuar të provojë aktakuzat kundër afër 43% të të akuzuarve.

Megjithatë, këtë përqindje të të dënuarve e përbëjnë kryesisht zyrtarët policor dhe qytetarët dhe jo zyrtarët e nivelit të lartë. Sipas aktgjykimeve të analizuar, ndaj 40 personave që nga Gjykata janë shpallur fajtorë, 24 prej tyre janë zyrtarë policor apo me qytetarë. Kështu, nga totali i

personave të dënuar sipas aktakuzave të PSRK, 60% e të dënuarve janë zyrtarë policor apo qytetarë. Pa këta zyrtarë policor dhe qytetarë, përqindja e personave të dënuar nga DS i GjTh në Prishtinë sipas aktakuzave të PSRK do të ishte vetëm 22.8% nëse të njëjtit nuk do të shpallehin fajtorë, apo vetëm 34.7% nëse aktgjykimet përkitazi me këto aktakuza nuk do të ishin subjekt i analizimit. Kështu, suksesi i PSRK në provimin e aktakuzave në raste të mëdha, sipas të cilave raste karakterizohet mandati i saj, është jashtëzakonisht i limituar.

Ndaj 40 personave të dënuar, gjykatat kanë shqiptuar 75 dënime. Në 46 raste (61.3%) DS i GjTh në Prishtinë ka shqiptuar dënim me burgim efektiv derisa në 29 raste të tjera (38.6%) është shqiptuar dënim me gjobë. Në kuadër të analizimit të aktgjykimeve të DS të GjTh në Prishtinë, IKD ka gjetur raste të mos respektimit dhe mos aplikimit adekuat të rrethanave lehtësuese e rënduese, ashtu siç përcaktohet Udhëzuesin për Politikë Ndëshkimore.

Bazuar në aktgjykimet e analizuara, IKD gjenë se problematikë mbetet mos aplikimi i dënimeve plotësuese, të cilat janë shqiptuar në vetëm 32.5% të rasteve. Në anën tjetër, në bazë të aktgjykimeve të analizuara, rezulton se në asnjë rast të vetëm të korrupsionit, DS nuk ka vendosur të konfiskojë pasurinë e përfituar me vepër penale. Vendimi për konfiskim është përfshirë në vetëm një rast të korrupsionit, por jo për vepër penale korruptive.

2. PSRK dhe Departamentet Speciale

Në qershor të vitit 2008 hyri në fuqi Ligji Nr.03/L-052 për PSRK. Përmes këtij Ligji, PSRK u themelua si organ prokurorial i përhershëm dhe i specializuar që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit, me kompetencë territoriale në gjithë Republikën e Kosovës. Në dhjetor të vitit 2023 ka hyrë në fuqi Ligji i ri nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale. Sipas këtij Ligji, PSRK ka kompetencat e saj të veçanta dhe plotësuese.

PSRK është kompetente të hetojë dhe të ndjekë veprat penale të cilat janë paraparë me këtë ligj, duke përfshirë veprat penale si veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës, rastet e korrupsionit të profilit të lartë, rastet e krimit të organizuar etj.¹

Që nga themelimi i PSRK e deri në janar 2019, kur hyri në fuqi Ligji NR. 06/L-054 për Gjykatat, PSRK nuk kishte një nivel gjyqësor ekuivalent për trajtimin e rasteve të saj. Kështu, përderisa në Kosovë funksiononte një Prokurori Speciale për ndjekjen e “krimeve speciale”, nuk kishte një gjykatë të tillë për gjykimin e këtyre rasteve. Departamenti që trajtonte aktakuzat e Departamenteve për Krime të Rënda të Prokurorive Themelore gjykonte po ashtu edhe rastet sipas aktakuzave të PSRK-së.

Kjo evidentohet si problematikë edhe në dokumentet e dala nga Procesi i Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, ku theksoj se *“Derisa në përgjithësi struktura organizative e sistemit prokurorial në Kosovë i është përshtatur sistemit gjyqësor, PSRK-ja përbën një përjashtim në këtë rast pasi që nuk ekziston asnjë gjykatë speciale e cila do të gjykonte rastet që bien në kompetencë të PSRK-së”*².

Kjo situatë zgjati për më shumë se një dekadë, deri në vitin 2019, kur hyri në fuqi Ligji Nr.06/L-054 për Gjykatat. Me këtë ligj, në kuadër të GjTh në Prishtinë dhe GjA, u themelua DS, me mandat për të trajtuar të gjitha lëndët që bien në kompetencë të PSRK-së. Ky ligj [neni 18] ka përcaktuar se *“Departamenti Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka kompetencë të shqyrtojë lëndët të cilat bien në kompetencë të PSRK-së, në pajtim me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet pasuese”*. Si shkallë e dytë për shqyrtimin e lëndëve të iniciuara nga PSRK DS funksion edhe në kuadër të GjA³.

Për këtë, njëri prej dokumenteve të dala nga Procesi i Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit thekson se “ligji i miratuar së fundi Nr. 06/L-054 për Gjykatat parasheh krijimin e DS në kuadër të GjTh në Prishtinë për rastet që janë në kompetencë të PSRK-së. Prandaj, në kuadër të skenarit afat-shkurtër, masat së pari duhet të ndërmerren për të fuqizuar

¹ Ligji Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale, neni 9 dhe 10.

² “Përmirësimi i Kornizës Institucionale për Luftimin e Korrupsionit”, fq.62, Ministria e Drejtësisë, Rishikimi Funkcional i Sektorit të Sundimit të Ligjit, 2019.

³ Ligji Nr.06/L-054 për Gjykatat, neni 24.1.1.3.

kapacitetet dhe burimet profesionale të këtij DS, konkretisht për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë”⁴.

Krahas rregullimit të strukturës institucionale, përmes krijimit të një departamenti të specializuar për trajtimin e aktakuzave të ngritura nga PSRK, supozohej të ngritej efikasiteti, efektiviteti dhe profesionalizmi në trajtimin e rasteve të iniciuara nga PSRK.

3. Efikasiteti i Departamentit Special në shkallë të parë

Një prej qëllimeve të themelimit të DS në GjTh në Prishtinë supozohet të ishte rritja e efikasitetit në trajtimin e rasteve të iniciuara nga PSRK. Megjithatë, me përjashtim të vitit 2020, DS i GjTh në Prishtinë nuk ka arritur të zgjidhë aq lëndë sa ka pranuar, duke u shtuar vit pas viti numri i lëndëve në punë.

Madje, për dallim nga vitet e tjera, në vitin 2020 kanë qenë të angazhuar vetëm gjashtë gjyqtarë dhe puna e gjyqësorit ishte reduktuar dukshëm për shkak të pandemisë COVID-19⁵.

Vitin 2020, Departamenti Special e kishte nisur me 63 lëndë të trashëguara dhe kishte pranuar 47 tjera, duke rezultuar me 110 lëndë total në punë. Ndërsa, ka arritur t’i zgjidhë 51 prej tyre, apo 46.4% të lëndëve në punë. Duke qenë ky vit i vetëm kur ky departament ka arritur që brenda një viti të zgjidhë më shumë lëndë sesa ka pranuar në po të njëjtin vit.

Ndërsa, në vitet 2021 dhe 2022 vërehet rënie e theksuar e zgjidhjes së lëndëve në raport me lëndët në punë. Në vitin 2021, nga 138 lëndë në punë, janë zgjidhur vetëm 37, apo 26.8% e tyre. Ndërkaq në vitin 2022, nga 163 lëndë në punë, janë zgjidhur vetëm 42 prej tyre, apo 25.8%.

Kurse, në vitin 2023 del të jetë një situatë pak më e mirë, pasi del se DS ka zgjidhur 32.5% të lëndëve që kanë qenë në punë. Ndonëse në këtë vit, DS kishte vetëm 10 gjyqtarë, për dallim nga dy vitet paraprake që kishin 12.

Në raport me lëndët e pranuar, gjatë vitit 2021, DS i GjTh në Prishtinë kishte zgjidhur 37 lëndë apo 35 lëndë më pak se sa që kishte pranuar. Shprehur në përqindje, krahasuar me numrin e lëndëve të pranuar, ky Departament kishte zgjidhur 51.4% të tyre. Gjatë vitit 2022, DS i GjTh në Prishtinë kishte pranuar 81 lëndë, gjersa kishte zgjedhur vetëm 42 prej tyre. Kështu, në raport me numrin e lëndëve të pranuar, DS i GjTh në Prishtinë kishte arritur të zgjidhë 51.85%.

Përkundër se as gjatë vitit 2023 DS i GjTh në Prishtinë nuk arrit që të zgjidhë as lëndë sa ka pranuar, kjo përqindje u rrit në 71.1%. Kështu, gjatë këtij viti, DS i GjTh në Prishtinë arriti të zgjidhë 60 lëndë përballë 82 lëndëve të pranuar.

⁴ Po aty.

⁵ “Performanca e sistemit të drejtësisë në trajtimin e krimeve speciale”, fq.9. Instituti i Kosovës për Drejtësi. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/09/Performanca-e-sistemit-te-drejtewise-ne-trajtimin-e-krimeve-speciale-Final-2.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024)

Nëse llogarisim numrin e lëndëve të zgjidhura me numrin e gjyqtarëve i bie që në vitin 2020, një gjyqtar ka zgjidhur mesatarisht 8.5 lëndë. Kurse në vitet 2021 dhe 2022, nuk u arrit që një gjyqtar mesatarisht të zgjidhë as katër lëndë. Konkretisht, në vitin 2021, mesatarja e zgjidhjes së lëndëve për gjyqtar ishte 3.1 lëndë derisa në vitin 2022 kjo mesatare ishte 3.5. Në vitin 2023 kjo mesatare pothuajse është dyfishuar, kjo pasi i bie që një gjyqtar mesatarisht të ketë zgjidhur gjashtë lëndë.

Kështu, vit pas viti, DS i GjTh në Prishtinë nuk arriti të zgjidhë aq lëndë sa ka pranuar, edhe përkundër rritjes së numrit të gjyqtarëve. Kështu, numri i lëndëve në punë u rrit vit pas viti, nga 63 lëndë në pritje në fillim të vitit 2020, në 125 lëndë në fund të vitit 2023.

4. Efikasiteti i Departamentit Special në shkallë të dytë

Sa i përket efikasitetit, Gjykata e Apelit del se qëndron shumë më mirë se sa Gjykata Themelore. Në këtë gjykatë, për këto katër vite, në vetëm njërin prej viteve kanë mbetur më shumë se 10 lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese, 12 sosh.

Ndërsa, në vetëm njërin prej viteve (2022), kjo Gjykatë nuk ka arritur që të zgjidhë lëndë po aq sa ka pranuar. Andaj, ai vit del të jetë i vetmi që në këtë kontekst ka një përqindje të efikasitetit nën 100% në raport me numrin e lëndëve të pranuar. Në vitin 2022, kjo përqindje ishte 86% derisa në vitin 2020 u shënuar përqindja më e lartë e zgjidhjes së numrit të lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuar (111,1%).

Krahasur me numrin e lëndëve në punë, efikasitetin më të lartë DS i GjA e pati në vitin 2020, ku arriti të zgjidhë 90% të lëndëve në punë, derisa më së ulëti, kjo përqindje ishte në vitin 2022 (78.2%).

Kështu, DS i GjA e ka zgjidhur çështjen e ngarkesës me lëndë ashtu që tanimë mund të konsiderohet se kjo gjykatë nuk ka ngarkesë të pamenaxhuar me lëndë.


Viti	Lëndë në pritje	Lëndët e pranuar	Lëndë në punë	Zgjidhura	Të pazgjidhura
2020	10	43	53	48	5
2021	5	36	41	36	5
2022	5	50	55	43	12
2023	12	55	67	57	10

Tabela 1. Trajtimi i lëndëve në Departamentin Special të Gjykatës së Apelit

5. Aktgjykimet në Departamentin Special të GjTh Prishtinë (2020 – 2024)


Për qëllime të pasqyrimin të punës, trajtimit të rasteve dhe politikës ndëshkimore të ndjekur nga DS i GjTh në Prishtinë, IKD ka analizuar 103 aktgjykime të publikuara nga ky Departament. Në kuadër të këtij numri bëjnë pjesë edhe 15 aktgjykime në rastet e korrupsionit, të cilave u bëhet një trajtim i veçantë.

Grafika në vijim tregon kategorinë e veprave penale sipas numrit të rasteve të analizuara:



Grafika 1. Ndarja e aktgjykimeve sipas veprës penale.


Grafika në vijim tregon kategorinë e veprave penale sipas numrit të personave të akuzuar në rastet e analizuara:



Grafika 2. Ndarja sipas personave të akuzuar.

6. Politika Ndëshkimore e Krimeve Speciale për periudhën 2020 – 2024

Gjatë analizimit të 103 aktgjykimeve për periudhën 2020 – 2024, IKD ka gjetur se politika ndëshkimore për krimet speciale ka qenë e ndryshme ku prej gjithsej 319 dënimeve të shqiptuara, 158 prej tyre kanë qenë dënime me burgim efektiv, 21 dënime me kusht dhe 140 dënime me gjobë.



Grafika 3. Ndarja sipas dënimeve të shqiptuara

Shprehur në përqindje i bie se 49.5% e masës së dënimeve të shqiptuara e përbëjnë dënimet me burgim efektiv. Ndërsa, 43.8% e dënimeve të shqiptuara janë dënime me gjobë. Përkatësisht, ky dënim është shqiptuar plot 140 herë. Në 6.5% të rasteve, DS i GjTh në Prishtinë ka shqiptuar dënim me kusht.

Në krahasim me numrin e rasteve që ka shqyrtuar, del se DS i GjTh në Prishtinë dënim me burgim më së shpeshti ka shqiptuar në rastet e veprave penale të armëve. Kjo kategori prinë edhe sa i përket dënimeve me gjobë. Ndërsa, sa i përket dënimeve me kusht, në proporcion me numrin e rasteve në punë, ky dënim më së shpeshti është aplikuar në rastet e veprave penale kundër ekonomisë.


Vepra penale	Numri i rasteve	Të akuzuar	Dënim me burg	Dënim me kusht	Dënim me gjobë	Lirim nga aktakuza	Refuzim
Terrorizëm	19	38	18	8	9	9	1
Korrupsion	15	70	46	/	29	19	21
Krim i Organizuar	10	43	20	/	22	14	1
Kundër ekonomisë	20	35	6	8	15	17	/
Kundër rendit kushtetues	4	5	4	/	3	/	/
Kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare	9	14	10	1	12	/	/
Të armëve	7	33	25	1		/	/
Kundër pasurisë	2	2	2	/	2	/	/
Të narkotikëve	7	25	19	/	22	1	/
Kundër jetës dhe trupit	4	8	5	1	/	1	/
Kundër të drejtave të votimit	2	2	/	2	/	/	/
Krime Luftë	4	5	3	/	/	1	/
Total	103	282	158	21	140	62	23

Tabela 2: Llojet e dënimeve të shqiptuara nga DS i GjTh PR, sipas kategorisë së veprave penale.

7. Aktgjykimet në DS në shkallë të dytë (2020 – 2024)

Nga 52 vendime të DS në GjA, të analizuar për qëllim të draftimit të këtij raporti, IKD ka gjetur se në pothuajse $\frac{3}{4}$ e rasteve, aktgjykimet e shkallës së parë janë vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë. Koncretisht, 38 prej tyre janë vërtetuar, në 12 raste janë ndryshuar dhe në dy raste të tjera lënda është kthyer në rigjykim.

Sa i përket rigjykimit, IKD ka gjetur një progres në këtë fushë, ku nga totali i vendimeve, DS i GjA në vetëm 3.8% të rasteve ka kthyer rastet në rigjykim, derisa në 23.1% të rasteve ka vendosur që t'i ndryshojë aktgjykimet e shkallës së parë.



Grafiku 4. Vërtetimi i aktgjykimeve nga Gjykata e Apelit.

8. Trajtimi i “korrupsionit special”

Për qëllime të draftimit të këtij raporti, IKD ka analizuar 15 aktgjykime të Departamentit Special në Prishtinë lidhur me rastet e korrupsionit, Në këto aktgjykime janë të përfshirë 70 persona, ndaj të cilëve janë shqiptuar 46 dënime me burgim, 29 dënime me gjobë ndërsa dënime me kusht nuk janë shqiptuar. Në 19 raste, të akuzuarit u liruan nga akuzat e prokurorisë derisa në 21 raste akuzat e PSRK u refuzuan.

a. Efikasiteti

Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve në sistemin e drejtësisë në Kosovë është një problematikë e vazhdueshme që ndikon në efektivitetin e drejtësisë dhe besimin e publikut ndaj institucioneve. Strategjia për Sundimin e Ligjit thekson se “Kohëzgjatja e procedurave mbetet një nga çështjet më kritike dhe komplekse të sektorit të sundimit të ligjit”.⁶ Vonesat në trajtimin e rasteve mund të çojnë në efektet negative, si zgjatja e periudhës së pasigurisë juridike për të akuzuarit dhe viktimat, si dhe ngarkesa e sistemit të drejtësisë.

Themelimi i DS supozohet se kishte për qëllim ngritjen e efikasitetit. Megjithatë, bazuar në aktgjykimet e analizuara, afati kohor për trajtimin e rasteve vazhdon të mbetet konsiderueshëm i lartë. Mesatarja e kohëzgjatjes së rasteve të trajtuara është 894 ditë, duke treguar një periudhë relativisht të gjatë pritjeje për shpalljen e aktgjykimet.

Megjithatë, kjo kohëzgjatje në plotëni nuk i atribuohet vetëm DS të GjTh në Prishtinë. Kjo pasi disa raste datojnë që nga koha kur DS i GjTh në Prishtinë nuk ishte krijuar ende. Megjithatë, edhe nëse në këto raste e llogarisim periudhës prej datës 8 korrik 2019, kur ky departament

⁶ Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021 – 2026, fq. 11. Korrik 20221. (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/04/Strategjia-per-Sundimin-e-Ligjit.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 12 dhjetor 2024).

është funksionalizuar⁷, prapë kohëzgjatja e trajtimit të rasteve është është e lartë, me mesatare 709.2 ditë.

Nr.	Data e ngritjes së aktakuzës	Data e shpalljes së aktgjykimit	Kohëzgjatja nga data e ngritjes së aktakuzës	Kohëzgjatja nga funksionalizimi i DS
1.	05.02.2020	27.06.2023	1238	1238
2.	24.02.2021	19.09.2023	937	937
3.	18.02.2022	20.03.2024	761	761
4.	14.06.2016	11.11.2022	2341	1222
5.	26.12.2019	26.10.2023	1400	1400
6.	12.10.2021	31.01.2023	476	476
7.	07.07.2021	05.07.2023	729	729
8.	08.05.2020	27.10.2023	1268	1268
9.	30.12.2014	02.11.2021	2499	848
10.	10.04.2020	04.01.2023	1000	1000
11.	07.04.2021	20.04.2022	378	378


⁷ “Funksionalizohet Departamenti Special në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë”. Këshilli Gjyqësor i Kosovës. 8 korrik 2019. (Shih linkun: <https://www.gjyqesori-rks.org/2019/07/08/funksionalizohet-departamenti-special-ne-gjykatën-e-apelit-dhe-ne-gjykatën-themelore-ne-prishtinë/>). (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024)

12.	21.03.2024	20.06.2024	91	91
13.	22.11.2023	12.04.2024	142	142
14.	21.03.2022	20.04.2022	30	30
15.	22.02.2022	22.06.2022	120	120

Tabela 3. Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve të korrupsionit në DS.

b. Cilësia e të akuzuarve

Bazuar në të dhënat e nxjerra nga aktgjykimet e analizuar, pozitat zyrtare që janë akuzuar më së shumti për vepra penale nga kapitulli i korrupsionit zyrtar përfshijnë qytetarët, personat zyrtarë dhe zyrtarët policorë. Koncretisht, qytetarët përbëjnë 29% të të akuzuarve, ndjekur nga personat zyrtarë me 24% dhe zyrtarët policorë me 23%.



Grafika 5: Pozita zyrtare e të akuzuarve për korrupsion.

c. Cilësia e të dënuarve

Sipas aktgjyqimeve të analizura, bazuar në aktakuzat e PSRK, nga 70 persona të akuzuar, 40 prej tyre janë shpallur fajtorë. Shprehur në përqindje, i bie se nga 70 personat që ka akuzuar PSRK, fajësia e të akuzuarve është vërtetuar në vetëm 57.14% të tyre. Kështu, Prokuroria ka dështuar të provojë aktakuzat kundër afër 43% të të akuzuarve.

Përballë faktit se aktakuzat e PSRK nuk kanë arritur të provohen në Gjykatë në gjithsej 43% të rasteve, nëse analizojmë pozitën zyrtare të personave të dënuar në Gjykata, atëherë rezulton se rastet të cilat janë provuar në Gjykatë kanë të bëjnë kryesisht me nivel zyrtarë të profilit të ulët apo me qytetarë.

Sipas aktgjykimeve të analizuara, ndaj 40 personave që nga Gjykata janë shpallur fajtorë, 24 prej tyre janë zyrtarë policor dhe qytetarë. Kështu, nga totali i personave të dënuar sipas aktakuzave të PSRK, 60% e të dënuarve janë zyrtarë policor apo qytetarë.

Kështu, edhe kur themi se 57.14% e të akuzuarve nga PSRK janë shpallur fajtorë nga DS i GjTh në Prishtinë, duhet ta kemi parasysh se 60% e dënimeve të shqiptuara ndaj këtyre personave janë zyrtarë policor apo qytetarë. Pa këta zyrtarë policor dhe qytetarë, përqindja e personave të dënuar nga DS i GjTh në Prishtinë sipas aktakuzave të PSRK do të ishte vetëm 22.8% nëse të njëjtit nuk do të shpallehin fajtorë, apo vetëm 34.7% nëse aktgjykimet përkitazi me këto aktakuza nuk do të ishin subjekt i analizimit.

Kështu, sukcesi i PSRK në provimin e aktakuzave në raste të mëdha, sipas të cilave raste karakterizohet mandati i saj, është jashtëzakonisht i limituar.

Nr.	Cilësia e të dënuarve	Numri i dënimeve	Përqindja e dënimeve
1.	Zyrtar policor	13	32.5%
2.	Qytetarë	11	27.5%
3.	Kryesues dhe anëtarë të komitetit qeveritar	4	10%
12.	Inspektor	2	5%
12.	Person zyrtar	2	5%
4.	Gjyqtar	1	2.5%
5.	Kryetar Komune	1	2.5%
6.	Drejtor i AKI	1	2.5%
7.	Ministër	1	2.5%
8.	Sekretar në Ministri	1	2.5%

9.	Drejtor në Ministri	1	2.5%
10.	Këshilltar i lartë politik i Ministrisë	1	2.5%
11.	Menaxher	1	2.5%

Tabela 4. Cilësia zyrtare e personave të dënuar.

d. Koha e kryerjes së veprave penale

Njëra prej arsyeve shtesë pse sistemi i drejtësisë duhet të veprojë me efikasitet është dhënia e përgjigjes së shpejtë në rastet e veprave penale. Reagimi i shpejtë i sistemit të drejtësisë ndikon që dukuri të ndryshme kriminale të parandalohen derisa kalimi i një afati tejet të gjatë në fund të procesit ia humb edhe kuptimin një dënimi.

Kryesisht, koha e kryerjes së veprës penale, sipas aktgjykimeve të analizuar është viti 2018. Megjithatë, në disa raste, është evidentuar se DS i GjTh në Prishtinë ka nxjerrë aktgjykime për vepra penale që sipas aktgjykimeve janë kryer në vitin 2012 apo 2013.

Koha e kryerjes	Numri i rasteve
2012	1
2013	1
2015	1
2018	6
2019	2
2020	2
2021	2


Tabela 5. Kur pretendohet se është kryer vepra penale dhe numri i rasteve për atë vit.

Aktgjykimet e nxjerra për vepra penale të cilat kanë ndodhur shumë vite më parë ia humbin kuptimin dënimeve të shqiptuara, paraqesin një reagim të vonuar të institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe përçojnë një mesazh negativ tek qytetarët.

e. Politika ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit

Në 15 aktgjykimet e analizuara, ku të përfshirë kanë qenë 70 persona, Gjykatat kanë shqiptuar 75 dënime ndaj 40 personave të cilët janë shpallur fajtorë.

Sa i përket dënimeve të shqiptuara nga DS i GjTh në Prishtinë, kryesojnë dënimet me burgim. Ky dënim është shqiptuar në gjithsej 46 raste, që përbën 61.3% të masës së dënimeve të shqiptuara, pasuar me 29 dënime me gjobë, që përbën 38.6 % të masës së dënimeve. Në aktgjykimet e analizuara, IKD nuk ka hasur në raste kur Gjykatat kanë shqiptuar dënime me kusht në rastet e korrupsionit.



Grafika 6. Politika ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit.

Gjatë analizimit të aktgjykimeve të rasteve të korrupsionit, përmes arsyetimit të këtyre aktgjykimeve IKD ka analizuar zbatimin e Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikën Ndëshkimore. Në kuadër të këtij analizimi, IKD ka gjetur raste të mos respektimit dhe mos aplikimit adekuat të rrethanave lehtësuese e rënduese, ashtu siç përcaktohet me këtë Udhëzues.

IKD ka identifikuar një rast kur rrethanën e njëjtë gjykata e ka konsideruar edhe si rrethanë rënduese edhe rrethanë lehtësuese. Kështu duke mos bërë aplikim adekuat të shqiptimit të rrethanave rënduese e lehtësuese.⁸

Gjithashtu kemi edhe rastin tjetër ku gjatë caktimit dhe llojit të lartësisë së dënimit, gjykata si rrethanë lehtësuese ka marrë pranimin e fajësisë si dhe keqardhjen, kështu duke bërë dyfishim të rrethanave lehtësuese.⁹ Kjo duke u bazuar edhe në udhëzues i cili decidivisht parasheh se

⁸ Aktgjykimi PS.nr.74/19 i datës 26.10.2023.

⁹ Aktgjykimi PS. 43/21 i datës 31.01.2023.

pendimi përbën rrethanën lehtësuese të pranimit të fajësisë andaj edhe nuk mund të merren si dy rrethana të ndryshme.¹⁰

Tutje, IKD ka hasur edhe në raste tjera të mosrespektimit të udhëzuesit ku gjykata ka marrë si rrethanë rënduese faktin se të akuzuarit kanë keqpërdorur pozitën e tyre si zyrtar policor duke vazhduar në paragrafin tjetër me faktin se të njëjtin ishin zyrtar policor. Në këtë mënyrë është bërë dyfishim i rrethanave rënduese, për të cilën udhëzuesi parasheh që t'i kushtohet vëmendje e veçantë me rastin e shqiptimit të dënimit.¹¹ Me një qasje të tillë po bëhet një praktikë e padrejtë në aplikim të rrethanave lehtësuese e rënduese pasi që në këtë mënyrë kryerësit të veprës penale i shqiptohet një dënim i padrejtë qoftë një dënim më i butë apo më i rëndë në mospërshtatshmëri me veprën penale të kryer dhe dënimin të cilën realisht e meriton.

Gjithashtu, kemi edhe rastin e gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, ku gjykata gjatë marrjes së vendimit, ka marrë për bazë si rrethanë rënduese faktin se i njëjti është person zyrtar i nivelit të lartë përkatësisht gjyqtar si dhe shkallën e përgjegjësisë penale duke përmendur faktin se vepra penale e marrjes së ryshfetit të cilën e kishte kryer, bie në domenin e kompetencave të tij si gjyqtar. Mirëpo, në aplikim të rrethanave lehtësuese e rënduese gjykata kishte përjashtuar veprën e dytë penale të armëmbajtjes pa leje.¹², duke mos dhënë shpjegim lidhur me caktimin e dënimit për këtë veprë penale. Pra mbi çfarë baze apo duke u bazuar në cilat rrethana lehtësuese e rënduese gjykata ka marrë vendim për veprën e armëmbajtjes pa leje. Udhëzuesi shumë qartë e parasheh se gjatë caktimit të dënimit duhet të merren për bazë rrethanat lehtësuese e rënduese në lidhje me parimet e përcaktuara me udhëzues.¹³ Mirëpo në këtë rast për këtë veprë penale nuk është dhënë asnjë shpjegim se mbi çfarë rrethanash është bërë caktimi dhe matja e dënimit.

Kështu, përkundër se në fushën e rasteve penale, DS supozohet të jetë Departamenti që duhet të tregojë cilësinë më të lartë të arsytimit të aktgjyqimeve, ka raste kur kjo nuk qëndron sa i përket arsytimit në lidhje me vendimin për matjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Në rastet e mësipërme, evidentohen raste kur Gjykatat nuk kanë respektuar Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore, si një dokument që në mënyrë adekuate sqaron dispozitat ligjore në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit.

f. Dënimet plotësuese

Numri i vogël i shqiptimit të dënimeve plotësuese vazhdon të mbetet një ndër sfidat kryesore në luftën kundër korrupsionit. Shqiptimi i këtyre dënimeve do duhej të ishte një nga "armët" më të forta të gjyqësorit për luftën efektive kundër korrupsionit, por që fatkeqësisht këto dënime po vazhdojnë të mos aplikohen mjaftueshëm ndaj veprave penale të korrupsionit. Mos aplikimi i dënimeve plotësuese për rastet e korrupsionit, ka qenë kritikë edhe te Raportit të

¹⁰ “Udhëzues për Politikën Ndëshkimore”, f.30. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, 2018.

¹¹ Po aty, f.31.

¹² Aktgjykimi PS.nr.10/20 i datës 27.06.2023

¹³ “Udhëzues për Politikën Ndëshkimore”, fq. 33-34. Gjykata Supreme e Kosovës. Prishtinë 2014. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).

Progresit për Kosovën për vitin 2023, ku ndër të tjera thuhej se dënimet plotësuese që ndalojnë ushtrimin e funksioneve publike në rastet e korrupsionit, nuk zbatohen mjaftueshëm¹⁴.

Bazuar në aktgjykimet e analizuara, IKD gjen se kjo problematikë është e shprehur edhe në aktgjykimet e DS. Në bazë të aktgjykimeve të rasteve të korrupsionit, të analizuara për qëllime të këtij raporti, rezulton se DS ka shqiptuar dënime plotësuese vetëm ndaj 13 personave të dënuar, nga gjithsej 40 persona të dënuar. Shprehur në përqindje, rezulton se dënimi plotësues është shqiptuar në vetëm 32.5% të rasteve.

g. Konfiskimi

Në bazë të aktgjykimeve të analizuara, rezulton se në asnjë rast të vetëm të korrupsionit, DS nuk ka vendosur të konfiskojë pasurinë e përfituar me vepër penale. Vendimi për konfiskim është përfshirë në vetëm një rast të korrupsionit, por jo për vepër penale korruptive por për armëmbajtje pa leje. Bëhet fjalë për rastin kur një të akuzuari i është konfiskuar arma pa leje.

Kështu, në bazë të këtyre aktgjykimeve, duket se “korrupsioni special” nuk po luftohet përmes konfiskimit të pasurisë së përfituar me vepër penale. Kjo qasje pamundëson dekurajimin dhe dobësimin financiar të kryerësve të veprave penale korruptive, duke ulur edhe gjasat për parandalim të kësaj dukurie. Luftimi i korrupsionit përmes konfiskimit të pasurisë së përfituar me vepër penale siguron që veprat penale të korrupsionit të ndëshkohen jo vetëm me dënime personale, por edhe me heqjen e përfitimeve materiale të fituara në mënyrë të paligjshme.

h. “Korrupsioni special” në shkallë të dytë

Sa i përket trajtimit të rasteve të korrupsionit në shkallë të dytë, në pesë raste është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë, kurse në 3 raste aktgjykimi është ndryshuar.

Prej pesë rasteve të korrupsionit që janë vërtetuar nga Gjykata e Apelit, tre prej tyre kanë qenë aktgjykime dënuese dhe dy tjerë lirues.

Në dy rastet e ndryshuara, të akuzuarit janë liruar nga akuzat, e që nga shkalla e parë kanë qenë të dënuar me dënim me burgim dhe me gjobë.

Nga rastet e analizuara, rezulton se DS i GjA nuk ka kthyer asnjë rast në rigjykim, çfarë konsiderohet aspekt pozitiv në këtë drejtim. Kështu, në tri (3) nga tetë (8) rastet e analizuara, DS i GjA e ka ndryshuar vetë aktgjykimin e nxjerrë nga shkalla e parë.

¹⁴ Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2023, fq24. (Shih linkun: https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/documents/2023/Kosovo%202023%20Report_SQ.PDF). (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).